Duke u bazuar në nenin 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.11 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/149 datë: 31.05.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 25.09.2020 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
**P R O C E S V E R B A L**

I MBLEDHJES SË -VIII- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 25.09.2020 (e premte) në ora 11.00 h. në sallën Nr.1 të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja znj.Medina Brahaj, pastaj anëtarët e Komitetit z.Perparim Ramusa, znj.Arbresha Syla, z.Naim Zejna, znj.Zarife Rexhaj, z.Ruzhdi Jashari, dhe znj.Adelina Beqaj. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Nënkryetari, z.Rrahman Jakupi; Zyrtarja Kryesore Financiare, znj.Kimete Ukaj; Zyrtari Ligjor, z.Lulzim Muharremi; Zyrtari për barazi Gjinore, z.Reshat Gashi; Praktikantja, znj.Mirjeta Hoxha; Zyrtari i IT-së z.Gazmend Ademaj. Mbledhjen e hapi, Kryesuesja e KPF-së znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

**REND DITE**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 06.07.2020,
2. Ridestinimi i Rezervës Buxhetore Komunale,
3. Prezantimi i Planit Buxhetor Komunal për periudhën 2021-2023,
4. Raport Periodik për zbatimin e rekomandimeve nga raporti i ZKA-së,
5. Shqyrtimi i Kërkesave

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Hapi diskutimin për Rendin e Ditës.
*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht aprovoi rendin e ditës.**

Pika 1
Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 06.07.2020
**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Hapi diskutimin për këtë pikë.
*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht aprovoi, Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 06.07.2020.**

Pika 2
Ridestinimi i Rezervës Buxhetore Komunale
**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Kimete Ukaj.
**znj.Kimete Ukaj, Zyrtare Kryesore Financiare;** Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, prezantoi para Komitetit këtë pikë në pikat më kryesore sipas propozimeve që janë dhënë për ridestinim të rezervës buxhetore. Propozim-Vendimin e keni marrë me kohë, tani i mirpres pyetjet e juaja, dhe po ashtu pres që ta miratoni këtë Propozim-Vendim, (shih dokumentin).

**z.Ruzhdi Jashari;** Te shkolla e Carralevës keni propozuar ndarje të sërishme të mjeteve edhe pse ne kemi dhënë mjete shtesë për këtë shkollë. Dyshohet që po ipen mjete për një operator të caktuar.
**z.Naim Zejna;** Përshëndetje, kam edhe unë disa vërejtje sikurse parafolësi. Është shkruar gabimisht "Është ndarë" kështu duhet të shkruhet pas aprovimit në Kuvend. Ne nuk po e dimë se ku janë këto rezerva, të cilat duhet me na i spejaguar.
**znj.Kimete Ukaj, Zyrtare Kryesore Financiare;** Ministria e Arsimit nuk e ka përfunduar, projektin e shkollës me të cilën jemi në bashkëfinancim. Krejt këto që janë në tabela, janë pare që kanë mbetur pa u shpenzuar e që në total janë 457,259.00€. Në vazhdim sqaroi lidhur me pyetjen e Naim Zejna ku i lexoi të gjitha tabelat se ku janë marrë dhe ku kanë me shkuar mjetet financiare.
**z.Ruzhdi Jashari;** Shkollat në Carralevë, Pjetërshticë e Muzeqinë kemi nda mjete për financimin e tyre, para kësaj mbledhje kemi dhënë 10%. Po shihet që aty punon firmna "Kadolli" që duhnet me i dhënë, dhe kjo është e pafalshme. Unë nuk do ta votoj, dhe kërkoj që të evidentohet në procesverbal.
**Nënkryetari, z.Rrahman Jakupi;** Ne në arsim kemi investuar vazhdimisht, por partitë tjera janë ato që nuk e duan këtë.
**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Konstatoi kuorumin prej 5 anëtarëve prezent në mbledhje.
*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 3 vota "Për" me 1 votë "Kundër" (z.Ruzhdi Jashari ka votuar kundër) dhe me 1 votë "Abstenim", vendosi t'i rekomandoj Kuvendit, aprovimin e Ridestinimit të Rezervës Buxhetore Komunale.**

Pika 3

Prezantimi i Planit Buxhetor Komunal për periudhën 2021-2023

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Kimete Ukaj.
**znj.Kimete Ukaj, Zyrtare Kryesore Financiare;** Prezantoi këtë pikë duke e lexuar tekstin e materialit, të cilin tha se e keni marrë edhe ju me kohë në formë të shkruar, (shih dokumentin).
Në vazhdim spejgoi me shifra sipas tabelave, bazuar në kodet ekonomike të ndarjes buxhetore. Plani buxhetor është dokumenti kryesor financiar i Komunës së Shtimes. Baza ligjore është dhënë në fillim të dokumentit. Unë i mirpres pyetjet dhe komentet e juaja, por pres gjithashtu që ti rekomandoni Kuvendit aprovimin e Planit Buxhetor.
**z.Ruzhdi Jashari;** Unë kam pyetje te rubrika 5 përkatësisht tabela numër 5 që ka të bëj me programin e arsimit, Klauzola e Investimeve, shpenzimet kapitale me na i sqaruar sepse shifra të tilla kemi edhe te tabela numër 2 qka nënkupton kjo? Pastaj pyetja tjetër direkte, sa mjete financiare shkojnë për pagesat e qirave fjalën e kam për të gjitha qiratë që paguhen nga buxheti i Komunës së Shtimes?
**z.Perparim Ramusa;** Përshëndetje, unë kam vetëm një pyetje, se a del në debat publik apo jo?
**znj.Kimete Ukaj, Zyrtare Kryesore Financiare;** Plani Buxhetor i miratuar nga Kuvendi, duhet të dërgohet në Ministri më së largu deri më 30.09.2020, kështu që rrjedhimisht nuk ka mundësi që të del në diskutim publik, sepse pra koha është e shkurtë.
**z.Perparim Ramusa;** Faleminderit për sqarimin. Sa i përket listës së projekteve kapitale që është rreth 2 milion, në bazë të renditjes së projekteve që është bërë, edhe unë kam vërejtje konkrete, e të cilat do ti ceki në mbledhjen e Kuvendit. 12,000.00€ që janë propozuar për çiklizëm, ndërkaq që në Zborc ende nuk kemi kanalizim. Pastaj po flitet për ndriçim në Belinc e në Carralevë e që unë konsideroj se janë një lluks në krahasim me sigurimin e kanalizimit e ujësjellësit. Prandaj unë propozoj që minimumi të shtohen edhe 25,000.00€ për kanalizim dhe asfalltim të rrugicave në fshatin Zborc.
**z.Naim Zejna;** Faleminderit për informatën, të njejtin shqetësim e kam edhe unë për sa i përket diskutimit publik. Pastaj te tabelat disa pyetje që i kemi propozuar ne si LDK-ë nuk janë futur në tekstin e dokumentit. Unë propozoj që ta bëjmë një takim paraprak me grupet parlamentare. Pastaj një vërejtje që materialin shtesë mos na i dërgoni por me kohë sepse pastaj nuk po mundemi që ta lexojmë.
**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Po e kam marë unë përsipër që ta organizoj një takim, para mbledhje së Kuvendit.

**znj.Adelina Beqaj;** Përshëndetje, pajtohem me propozimin që ndriqimi publik është lluks në krahasim me kanalizimin e ujësjellësin, por nuk pajtohem që në fshatin Belinc të hiqet edhe trotuari, ky projekt duhet të qëndrojë aty.
**znj.Kimete Ukaj, Zyrtare Kryesore Financiare;** Materiali i planit Buxhetor na ka ardhur me vonesë nga Ministria. Mirëpo ne po punojmë sipas mundësisë kohore mjaft të kufizuar edhe për shkak të pandemisë KOVID19 me qëllim që ta përgatisim një plan buxhetor sa më të mirë. Sa i përket pagesave që duhet të bëhen për qiratë, mjetet paguhen në bazë të thirrjeve publike. Te projektet e kontraktuara ne veq jemi hy në obligime dhe ne duhet që ti përmbushim këto obligime.
**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Konstatoi kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.
*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 3 vota "Abstenim", vendosi t'i rekomandoj Kuvendit, aprovimin e Planit Buxhetor Komunal për periudhën 2021-2023.**

Pika 4

Raport Periodik për zbatimin e rekomandimeve nga raporti i ZKA-së

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Kimete Ukaj.
**znj.Kimete Ukaj, Zyrtare Kryesore Financiare;** Prezantoi këtë pikë, duke theksuar se Auditori i Përgjithshëm, gjatë auditimit që ka bërë në Komunën tonë ka 11 të gjetura. Kështu që ne e kemi bërë një plan për zbatimin e këtyre rekomandimeve. Me Ligj jemi të obliguar që të raportojmë në Kuvend lidhur me zbatimin e këtyre rekomandimeve. Prandaj unë nuk do ta zgjati më shumë, por ju ftoj që nëse ka dikush pyetje lidhur me Planin për zbatimin e rekomandimeve, unë jam këtu për tu përgjigjur.
Pres gjithashtu që ti rekomandoni Kuvendit aprovimin e Raport Periodik për zbatimin e rekomandimeve nga raporti i ZKA-së.
**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Konstatoi kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.
*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota "Për" me 1 votë "Kundër" dhe me 2 vota "Abstenim", vendosi t'i rekomandoj Kuvendit, aprovimin e Raportit Periodik për zbatimin e rekomandimeve nga raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit.**

Pika 5

Lista e kërkesave

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Kemi një shkresë nga MAPL-ja, e cila na ka rekomanduar që kërkesat 2, 3, 4 dhe 5 ti shtyejmë për shqyrtim, për ti analizuar se qka do të veprojmë më tutje ku po bëhet fjalë pra për kërkesat 2, 3, 4 dhe 5 sipas Listës së Kërkesave Npi-01/194. Mbi bazën e kësaj që u tha unë propozoj që këto kërkesa të shtyhen.
**z.Naim Zejna;** Unë kam një vërejtje të vogël, po kërkoj që DPUKGJ-ja le ti aktualizon këto kërkesa me Orto-Foto, me Fleta poseduese, me Skica e të tjera, sepse janë të vjetëruara, dhe tani duhet që këto dokumenta ti kemi të reja.
**z.Ruzhdi Jashari;** Edhe unë pajtohem që këto kërkesa duhet me u shty. Gjithëmonë kur veprohet për ta dhënë një pronë në shfrytëzim duhet të bëhet përmes thirrjes publike, e që kjo nuk po ndodhë, prandaj po kemi probleme të vazhdueshme që po na i kthen MAPL-ja në rishqyrtim vendimet për pronat komunale që po i jepni në shfrytëzim.
**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Këto janë vendime për shpallje paraprake.
**z.Perparim Ramusa;** Për cilat pika po bëhet fjalë?
**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Po bëhet fjalë për kërkesat 2, 3, 4 dhe 5.
**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Konstatoi kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

1. z.Sali Beqa - Petrovë, Kërkesa Nr.01-070/05-6235/20 datë:09.03.2020,
2. z.Salami Rashiti - Petrovë, Kërkesa Nr.01-070/05-16704/20 datë:26.08.2020,
3. z.Albnor Shehu – Rr."Xhamia" Nr.5 Doganaj–Kaqanik, Kërkesa Nr.01-070/05-18513/20 datë: 16.09.2020,
4. z.Eqrem Krasniqi - Dugë, Kërkesa Nr.02-070/05-14205/20 datë: 06.08.2020,

5. z.Bekim Shashivari, Rr. "Dëshmorët e Reqakut" – Shtime, Kërkesa Nr.01-070/05-18848/20 datë: 21.09.2020.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi që Kërkesat: 2, 3, 4 dhe 5 të kalojnë direkt në Kuvend, me arsyetimin se në ndërkohë kemi pranuar një shkresë zyrtare nga MAPL-ja lidhur me këto kërkesa, dhe jemi në konsultime paraprake, deri në mbledhjen e Kuvendit më 29.09.2020.**

1. z.Sali Beqa - Petrovë, Kërkesa Nr.01-070/05-6235/20 datë:09.03.2020,

**znj.Zarife Rexhaj;** Përshëndetje, unë kam një pyetje, a ka ardhur një kërkesë e fshatit Davidovc, me E-mail, sepse ata kanë thënë që e kanë bërë një një kërkesë dhe e kanë dërguar me E-mail. Realisht unë jam për me bërë një zgjidhje lidhur me këtë kërkesë të Sali Beqaj.

**znj.Adelina Beqaj**; Vërtetë kjo kërkesë shkoi gjatë, kështu që unë jam për me bërë një zgjidhje, sepse Sali Beqaj është në rregull me dokumenta.

**z.Naim Zejna;** Edhe unë i bashkëngjitem propozimeve që me bërë një zgjidhje. Ai është pronarë i tokës, kështu që unë kam propozuar që fillimisht qështja të kthehet në pikën zero. Banorët e fshatit Davidovc kanë thënë se kanë bërë një kërkesë, por unë tani nuk e di saktë se ku. Unë jam që së bashku me e kaluar këtë dhe me bërë një zgjidhje. Unë propozoj që kërkesa të shkojë direkt në Kuvend.

**z.Perparim Ramusa;** Edhe unë jam për me kaluar direkt në Kuvend.

**z.Ruzhdi Jashari;** Le të dihet që kjo çështje për Komunën e Shtimes ka përfunduar, nëse ka gabime le të shkon çështja në Gjykatë.

**znj.Arbresha Syla;** Fillimisht kërkoj falje për vonesën, që ka ndodhë për shkak të punës. Sa i përket kërkesës ne jemi këtu për të bërë zgjidhje për problemet dhe nevojat që kanë qytetarët. Për pa aftësi është mirë që me e lëshuar Komitetin, dhe vinë të tjerët.

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;** Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 5 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim", vendosi se nuk ka rekomandim për Kuvendin lidhur me kërkesën e Sali Beqaj.**

**Kryesuesja, znj.Medina Brahaj:** Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesja, mbledhjen e përfundoi ne ora 12.20h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi

v.v.

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E SHTIMES-OPŠTINA ŠTIMLJE SHTIME-ŠTIMLJE

Kryesuesja e KPF
Medina Brahaj